



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

VENDIM

Nr. 13, datë 15.05.2019

MBI

**“MIRATIMIN PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË
STUDENTES TË CIKLIT TË PARË BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2018-
2019, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA, TË UNIVERSITETIT TË
ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, date 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar); urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 51, datë 03.12.2018 mbi “Ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen/reduktohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019, në Universitetin e Arteve”(i ndryshuar), si dhe bazuar në kërkesën e studentes të Fakultetit të Arteve të Bukura Maria Taragjini me datë 22.04.2019, Bordi i Administrimit pasi diskutoi rreth Relacionit në lidhje me kërkesat e studentëve, paraqitur nga Administratori i UART znj. Alma Sinanaj dhe duke u bazuar në aktet e dala për këtë qëllim dhe pasi e diskutoi,

VENDOSI:

1. Miratimin për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentes Maria Taragjini, e ciklit të parë të studimeve Bachelor, në programin e studimit Skulpturë, të Fakultetit të Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2018-2019.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik Bisha (Kryetar)

Risena Xhaja (Anëtar)

Prof. Arben BASHA (Anëtar)

Aida Martiro (Anëtar)

Prof. Artan Peqini (Anëtar)

Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)

Lorenc Vangjoli (Anëtar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ADMINISTRATOR
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 663 prot.

Tiranë, më 13.05.2019

Lënda: Kërkesë për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit të 2 studentëve që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë Bachelor, në Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018 – 2019.

Drejtuar: Prof. Besnik Bisha
Kryetar, Bordi i Administrimit

I nderuar Z. Bisha,

Pranë zyrës së protokollit në Rektorat, janë depozituar kërkesat për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit e studentit Alban Xhafa me datë 19.04.2019 dhe e studentes Maria Taragjini me datë 22.04.2019, studentë të cilët studiojnë pranë Fakultetit të Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve.

Studentja Maria Taragjini, për vitin akademik 2018 – 2019 është studente në vitin e parë Bachelor, në programin e studimit Skulpturë. Në kërkesën e saj të depozituar, studentja Maria Taragjini, justifikohet se nuk ka aplikuar, sipas Formularit për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, brenda afateve të caktuara nga UART, si rezultat i mungesës së aftësive, pasi është person me aftësi të kufizuar që nuk flet dhe nuk dëgjon, gjë e cila justifikohet edhe nga dokumentacioni mjeko-ligjor të dorëzuar bashkëlidhur kërkesës, si dhe se nuk ka marrë informacionin e duhur në kohë nga Fakulteti i Arteve të Bukura.

Studenti Alban Xhafa, aktualisht për vitin akademik 2018 – 2019 është student në vitin e dytë Bachelor. Në kërkesën e tij të depozituar, studentin Alban Xhafa, kërkon përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018, pasi Vendimi i Bordit të Administrimit për këtë student, për vitin akademik 2017-2018 ishte për mos përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për arsyen se në vitin e parë akademik nuk ishte regjistruar në kuotat e Komunitetit Egjyptian. Kërkesën e tij, Studenti Alban Xhafa, e mbështet bazuar në vendimin që ka marrë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për studentët e Fakultetit të Muzikës, të cilët kanë aplikuar si pjesëtar të Komunitetit Egjyptian dhe të cilët në Vendimin e Bordit të Administrimit nuk kanë përfituar përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017-2018, për të njëjtën arsye si studentin Alban Xhafa, por mbas ankimimit të Vendimit të Bordit të Administrimit pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ky vendim i BA është cilësuar si i padrejtë dhe është marrë vendim për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe duke u bazuar në këtë vendim të marrë, studentin Alban Xhafa, kërkon përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, date 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar), po Ju përcjellim për tu trajtuar nga ana e Bordit të Administrimit, kërkesat e studentëve të Fakultetit të Arteve të Bukura, Maria Taragjini dhe Alban Xhafa.

Me konsideratë,

ADMINISTRATOR

Alma Sinanaj



Miratoi: E. Plaku
Konceptoi: T. Kamberi
Ekz.: 3 (tre)